

BIO

Dr. Antoneta Ramaj ka përfunduar studimet e larta në degën "Gjuhë shqipe dhe letërsi" në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Ajo ka zhvilluar studimet "Master në metodikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe" po në këtë fakultet në departamentin e gjuhësisë dhe ka titullin "Doktor shkencash" në gjuhësinë e aplikuar, mbrojtur në Qendrën e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Gjatë viteve 1993-1998 ka qenë metodiste e gjuhës shqipe në Tiranë, ndërsa në vitet 2002-2005 ka punuar inspektore në Drejtorinë Arsimore të qytetit të Tiranës. Në periudhën 2007-2010 ka qenë specialiste e kurrikulës së gjuhës shqipe në Institutin e Kurrikulës dhe të Trajnimeve (IKT), ndërsa nga viti 2010-2019 ka punuar në Drejtorinë e Vlerësimit të Kurrikulës pranë Inspektoratit Kombëtar të Arsimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Viti 2019 e në vijim, e gjen znj. Ramaj në Drejtorinë e Vlerësimit të Cilësisë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Krahas kësaj, nga viti 2015 punon si pedagoge e jashtme në departamentin e edukimit pranë Universitetit "Marin Barleti", Tiranë.

Ajo është autore e teksteve në ndihmë të mësuesve, si dhe i disa artikujve shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit.

Antoneta Ramaj ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e testeve në provime kombëtare (lirimi dhe matura shtetërore).

Gjithashtu, ajo ka qenë anëtare dhe ka drejtuar grupe pune në projekte që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe është trajnere kombëtare e ndërkombëtare në çështje të ndryshme që lidhen me zhvillimin e shkollës.

Që nga viti 2023 e deri më tani ai është lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.



ANTONETA RAMAJ

DOKTOR I SHKENCAVE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Antoneta Ramaj është pedagoge pranë Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- hulumtimi në fushën e arsimit,
- hartimi, zhvillimi dhe vlerësimi i kurrikulës në përgjithësi dhe i kurrikulës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë në veçanti
- trajnimi i mësuesve
- metodologjia e mësimdhënies
- vlerësimi i nxënësit
- zhvillimi i mendimit kritik
- gjithëpërfshirja në arsim
- vlerësimi i shkollës

EMAIL

a.ramaj@umb.edu.al